



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 558/4 prot.

Tiranë 11.11.2016

V E N D I M

Nr. 122 Datë 11/11/2016

Mbi përfundimin e procedimit administrativ, për verifikimin e disa pretendimeve, ngritur prej punonjësës *** , për shkelje të ligjshmërisë gjatë procesit të ristrukturimit të KQ Fier dhe lirim e padrejtë nga shërbimi civil**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenit 108 - 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe nenit 13, 14 gërma "a" dhe 34, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të administruar dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit protokolluar pranë Komisionerit me nr. 558 prot., datë 07.09.2016, mbi zbatimin e ligjshmërisë në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për punonjësën ***** për shkak të ristrukturimit,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr.558 prot., datë 07.09.2016, ka marrë dijeni për disa shkelje të pretenduara në lidhje me mënyrën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procesit të ristrukturimit të institucionit Këshilli i Qarkut Fier. Për këtë arsye, bazuar në Urdhrin nr. 558/1 prot., datë 14.10.2016 "Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 6, dt. 20.07.2016, të Kryetarit të Këshillit Qarkut Fier "Për lirim nga shërbimi civil" të nëpunësës *****", ka kryer verifikimin e këtij rasti, prej nga ka rezultuar si më poshtë:

***** ka qenë punonjëse në Këshillin e Qarkut Fier në pozicionin "Specialiste e turizmit", në Drejtorinë Ekonomike dhe të Shërbimeve, pranë Këshillit të Qarkut Fier, emëruar pas procedurës së konkurrimit, me vendimin nr. 55, dt. 02.11.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut.

Më pas, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe në mbështetje të ligjit nr. 147/2015, dt. 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016", për reduktimin e buxhetit të institucionit e për rrjedhojë edhe të personelit administrativ, Kryetari

i Këshillit të Qarkut Fier, mbi bazën e projekt-strukturës (pa kaluar akoma kjo në Këshillin e Qarkut, për miratim), ka nxjerrë urdhrin nr. 12, dt. 17.06.2016, me anë të të cilit ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit.

Në vijim të këtij procesi, me cilësinë e drejtuesit të institucionit, nëpërmjet shkresës nr. 611/14 prot., dt. 20.06.2016, ai ka njoftuar nëpunësen *****, për shkurtimin e vendit të punës për shkak rristurimi. Pas miratimit të strukturës së re me vendimin nr. 6, dt.30.06.2016, Kryetari i Këshillit të Qarkut Fier, pa pritur propozimet e Komisionit të Ristrukturimit përpara njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 6 dt. 20.07.2016, ka vendosur lirim të saj nga shërbimi civil.

Nga analiza e përmbajtjes së akteve të mësipërme, vërehet fakti që në bazë të strukturës së re, ka shkurtim të dukshëm të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë, gjë e cila në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përbën shkak të ligjshëm për vënien në diskutim të vazhdimësisë së marrëdhënies së punësimit për ata punonjës, të cilëve u ishte shkurtuar apo riorganizuar vendi i punës dhe Komisioni i Ristrukturimit, do të bënte propozimin përkatës para njësisë përgjegjëse.

Por gjatë kryerjes së këtij procesi, janë lejuar/kryer gabime në zbatimin e kushteve dhe procedurës së parashikuar prej ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e konkretisht në mënyrën e zbatimit të pikës 1, të nenit 50 të tij, në të cilën përcaktohet se vetëm nëse për shkak të mbylljes apo rristurimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet, sipas radhës dhe përparësisë që parashikon pika 2, e dispozitës në fjalë dhe vetëm nëse kjo është objektivisht e pamundur, vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil (pika 6, e nenit 50, të ligjit nr.152/2013).

Si rregull, Komisioni i Ristrukturimit duhet të analizonte gjithë karakteristikat e pozicioneve të mbetura të punës dhe të dhënat e gjithë nëpunësve civilë ekzistues e mbi këtë bazë të përpilonte propozimin përkatës, për lirim nga shërbimi civil të atyre nëpunësve, pozicioni i të cilëve realisht kishte pësuar shkurtim, duke patur parasysh këtu riformatimin apo riorganizimin e pozicioneve të punës dhe ndryshimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të pozicioneve të mbetura pas rristurimit, për të siguruar kryerjen e funksioneve bazë të institucionit.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar konstatohet se, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka funksionuar si duhet dhe nuk e ka përfunduar detyrën e tij, duke mos nxjerrë aktet përkatëse, ashtu siç kërkon pika 3, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, ky organizëm (komisioni i rristurimit) nuk ka arritur të bëjë analizën krahasuese të kërkesave të pozicioneve të mbetura të punës me karakteristikat dhe cilësitë personale të nëpunësve ekzistues të institucionit, për të realizuar mbajtjen në punë të punonjësve më me eksperiencë dhe me aftësi profesionale e organizative. Ky komision, gjithashtu, nuk ka bërë propozimet përkatëse përpara njësisë përgjegjëse, në lidhje me punonjësit që do të mbeteshin në punë pas rristurimit dhe ata që do të liroheshin nga detyra për shkak të shkurtimit të vendeve të punës. Konstatohet se, puna e komisionit është dubluar dhe përfundimisht, kompetencat e këtij të fundit, janë marrë nga drejtuesi i institucionit, duke sjellë në këtë mënyrë pavlefshmëri absolute të këtij veprimi administrativ, të kryerjes së rristurimit.

Një nga shkaqet që ka ndikuar në këtë drejtim është dhe fakti që, Kryetari i Këshillit të Qarkut Fier, me cilësinë e drejtuesit të institucionit, gjatë kohës së funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës të njërit prej anëtarëve të tij, gjë që ka sjellë prishjen e përbërjes së komisionit dhe për rrjedhojë, ndërprerjen e veprimtarisë së tij.

Një moment tjetër parregullsie dhe paligjshmërie, i cili parashikohet si i tillë nga pika 2, e nenit 4, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* është edhe fakti që, fillimi i veprimit administrativ për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për këtë punonjëse, nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier (me aktin nr. 611/14 prot., dt.20.06.2016), është kryer përpara se Këshilli i Qarkut të miratonte strukturën e re (e cila është miratuar me vendimin nr. 6, dt. 30.06.2016, të Këshillit të Qarkut Fier).

Sa më sipër, duke vepruar në këtë mënyrë, Kryetari i Këshillit të Qarkut Fier ka shkelur procedurën e nxjerrjes së akteve që pasojnë procesin e ristrukturimit, si dhe kompetencën e organit publik, që ka të drejtë të trajtojë dhe paraqesë propozimet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, gjë që në vështrim të nenit 108, pika i) dhe ii), të germës a), të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, e bën aktin absolutisht të pavlefshëm. Nga ana tjetër, në vështrim të nenit 109, pikat a), b), d) dhe dh) të ligjit, për mungesë të kompetencës, shkelje të procedurës dhe ushtrim të diskrecionit në mënyrë të gabuar, ky akt është i paligjshëm.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit në fjalë, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, si i tillë. Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Këshillit të Qarkut Fier, duhet të konstatojë ekzistencën në këtë veprim administrativ të rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113 të po këtij ligji, të bëjë anulimin e aktit nr. 6, dt. 20.07.2016, si dhe akteve të tjera që kanë shoqëruar kryerjen e procesit të ristrukturimit.

Duke qenë se, në bazë të pikës 2, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, anulimi i aktit ka pasoja për të shkuarën, për rregullimin e ligjshmërisë së këtij rasti, duhet që gjithë procesi të fillojë nga e para, duke nisur me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe kryerjen e procedurës prej tij, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndyshuar dhe Kreut II, pikat 16 e vijuese, të Vendimit nr. 125, dt. 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*.

Për këto arsye

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*; neneve 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe nenin 35, të Rregullores *“Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, të miratuar me Vendimin nr.17, dt.11.03.2015,

V E N D O S A:

Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që, për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë, të veprojë si më poshtë:

1. Të drejtojë procesin e anulimit nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, të vendimit nr. 6, dt. 20.07.2016, *“Për lirim nga detyra”*, për nëpunësen *****.
2. Të drejtojë procesin e anulimit nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier, të aktit nr.12, dt.17.06.2016, për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe të ngritjes përsëri të

Komisionit të Ristrukturimit, me përbërje tjetër, duke e filluar procesin nga e para, sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut II, pikat 16, 17, 18, etj., të Vendimit nr. 125, dt. 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë” dhe vetëm në pamundësi objektive të sistemit të punonjësve që u është shkurtuar, ose riestrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

3. Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që, në zbatim të pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për ata nëpunës për të cilët do të vendoset lirimi nga detyra për shkak të shkurtimit, apo riestrukurimit të vendit të punës, të urdhërohet dhënia e shpërblimit në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe të deklarohet e drejta, që brenda një periudhe 2-vjeçare nga momenti i përfundimit të marrëdhënies së punës, ata do të kenë mundësi të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.
5. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Këshilli i Qarkut Fier dhe punonjësja ***** .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA